

ANALIZA E RISKUT PARA AUDITUES DHE PASVIJUES NË KUSHTET E KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË AKTIT

nga Helga VUKAJ

botuar në gazetën "Ekonomia", më 08 maj 2014.

Në dijeninë e çdo teknikieni, risk do të thotë rrezik nga një veprim i caktuar, veprimtari dhe /ose mosveprim, e parashikuar apo e paparashikuara, por jo vetëm. Ai mund të konsiderohet edhe si paramendimi a paragjykimi për veprime apo mosveprime në keqbesim.

Nocioni nënkupton se nuhatja e riskut mund të jetë ose jo cilësi e iniciatorit (kemi parasysh rastin kur në kushtet e një auditimi rutinë), por ndërhyrja bëhet e pashmangshme kur risku është i dukshëm dhe evident për shkak të vet pasojave që mund të ketë shkaktuar apo faktit të njohjes botërisht të tij. Ndonjëherë edhe humbjet e mundshme apo rezultatet e padëshiruara mund të quhen "risk". Çdo përpjekje e njeriut përtej normales, ligjores dhe të rregulltës, mbart një risk, por disa në fakt janë shumë më me risk se të tjerat.

Qëllimi i veprimtarisë së çdo të ngarkuari/audituesi është të zbulojë, evidentojë dhe pasqyrojë realisht rastin (riskun), në funksion të cilësisë së veçantë që i ka atribuar kushtetuta dhe ligji, si i besuar dhe i autorizuar për të qenë məkëmbës i pavarur, i paanshëm dhe profesionist i këtyre dy akteve shumë të rëndësishëm ligjorë. Nisur nga ky pozicion, çdo auditues duhet të ketë përgatitje të lartë profesionale dhe të jetë i përditësuar me aktet dhe nënaktet që orientojnë fushat e veprimtarisë; duhet të azhurnohet me informacion të drejtpërdrejtë e jo të drejtpërdrejtë por që klasifikohet si fakt i njohur botërisht; duhet të jetë i vëmendshëm ndaj shqetësimeve rutinë që përcillen nga ankues apo letërshkrues të ndryshëm, të adresuar në institucion, etj.

Suksesi i audituesit në nuhatjen e riskut dhe evidentimin e tij varet edhe nga aftësia e tij për të qenë i orientuar në marrjen e informacionit të brendshëm në institucionin objekt auditimi dhe vlerësimin e risqeve të dukshme ose jo. Në rast se do të konsiderohemi të kualifikuar në të gjitha këto cilësi, bazuar edhe në parimet e

së drejtës, objektivitet, paanësi, ligjshmëri e profesionalizëm, na mbetet vetëm të presim sukses në fund të auditimit.

Në kushtet e një pritshmërie të tillë lind natyrshëm edhe nevoja e garantimit të sigurisë dhe cilësisë përmes analizës të riskut pasvijues. Të analizosh riskun pasvijues do të thotë të kalosh në sitë vlerësimi, të gjitha hapat pre dhe post identifikim të riskut spontan dhe josponan të zbuluar nga një auditues; analizën logjiko teknike të përdorur në funksion të zbulimit dhe masës rregullatore dhe nëse është përdorur gjithë dokumentacioni i nevojshëm për të qenë një zbulim efikas dhe efektiv.

Menaxhimi i riskut pasvijues nxitet të funksionojë në një institucion administrativ edhe bazuar në përcaktimet e të drejtës, pikërisht nga neni 18 i Kodit të Procedurave Administrative, i cili shpreh parimin e kontrollit të brendshëm po aq të rëndësishëm sa ai gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave, veprimtaria administrative i nënshtrohet: kontrollit të brendshëm administrativ në përputhje me dispozitat e këtij Kodi....

Arsyet që kanë determinuar këtë qëndrim të legjislatorit janë të shumfishta. Kështu së pari, kontrolli i brendshëm i aktit do të reduktonte riskun e goditjes së aktit ku përfshihen edhe konkluzionet në gjykatë. Pra i jep siguri aktit. Së dyti, është proces me kosto më të ulët, sepse administrata i ka të gjitha mundësitë të korrigjojë gabimet e mundshme pa vështirësi. Po kështu, administrata është në një pozicion më të mirë sesa gjykata për të gjykuar e vendosur për problemin pasi a njeh më mirë atë.

Së treti, gjykimi i administratës mund të preket nga vese të tilla si konflikti i interesave, të cilat do ta bënin të pabesueshëm konkluzionin, dhe kjo padyshim që do manaxhuar si post risk.

Së katërti, në rrethanat kur zgjerimi i vazhdueshëm i kompetencave të administratës publike sjell për pasojë rritjen e vazhdueshme të kontakteve mes kësaj të fundit dhe publikut të gjerë, edhe mundësia e abuzimit të pushtetit rritet në përpjestim të drejtë dhe kjo vlen të kontrollohet se sa e ekuilibruar ka qenë në momentin e konkluzioneve të dhëna nga i ngarkuari/audituesi në raport edhe me konfliktin e interesave.

Së pesti, analiza e riskut pasvijues ka për qëllim ballafaqimin e gjetjes me mosgjetjen dhe moszbulimin që do të thotë se në rast se risku ka qenë i identifikuar paraprakisht në rrethanat e një hamendësie prej profesionisti dhe rezulton që ai të ketë pësuar devijim për shkak të kësaj dijenie/hamendësie të përdorur me keqbesim, atëherë risku kthehet në risk kompleks (jo vetëm i jashtëm por edhe i brendshëm), dhe pasojat natyrisht që shumëfishohen në kushtet e rëndesës së një kundraligjshmërie, e kushtueshme juridikisht, financiarisht apo ekonomikisht. Keqbesimi mund të shfaqet që në fillim duke u shmangur në përzgjedhje, gjatë përzgjedhjes dhe gjatë analizës së veprimeve me natyrë juridike apo financiare. Padyshim që këto monitorohen dhe vlerësohen në kuadër të ruajtjes dhe garantimit të cilësisë nga struktura kompetente në institucionin e KLSH, si Drejtoria Juridike, Sigurimit të Cilësië dhe Analizës së Riskut.

Analiza e mësipërme përkon me realitetin i cili mbart edhe risinë e implementimit të takimeve mirëkuptuese/ballafaquese përmes të cilave rikonfirmohet edhe njëherë transparenca dhe realiteti faktik i çështjeve, ç'ka forcon pozitën e institucionit të KLSH në zbatim të parimit të ligjshmërisë, proporcionalitetit, objektivitetit dhe paanshmërisë.

Kjo është ngritja e një sistemi të përgjegjshëm në raport me detyrat e detyrimet!